



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.11.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të datave 24.09.2020, 28.09.2020, 30.09.2020, 01.10.2020, 02.10.2020, 07.10.2020, 09.10.2020, 12.10.2020, 12.10.2020 (ora 14:30), 13.10.2020, 14.10.2020, 15.10.2020, 19.10.2020, 20.10.2020, 21.10.2020, 21.10.2020 (ora 17:00), dhe 26.10.2020.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:10.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në pikën e parë të rendit të ditës anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 24.09.2020, 28.09.2020, 30.09.2020, 01.10.2020, 02.10.2020, 07.10.2020, 09.10.2020, 12.10.2020, 12.10.2020 (ora 14:30), 13.10.2020, 14.10.2020, 15.10.2020, 19.10.2020, 20.10.2020, 21.10.2020, 21.10.2020 (ora 17:00), dhe 26.10.2020.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 26 nëntor 2020.

Është në pamundësi për t'u përfshirë "online" vetëm zonja Ukperaj për shkak të problemeve që ka të lidhjes "online", kështu që, duke mos dashur që të pengojmë ecurinë e mbledhjes, unë vazhdoj mbledhjen edhe pa prezencën e zonjës Ukperaj.

Në rend të ditës sot janë 8 çështje, ku e para është miratimi i procesverbaleve për mbledhjet respektive (siç i kemi shënuar).

Së dyti është shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e "Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor".

Së treti është shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e modelit të hartimit të "Projekt-raportit të Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarit".

Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e Rregullores “Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median””.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”.

Dhe janë dy projekt-akte, shqyrtimet e projektvendimeve “Për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, konkretisht për kandidatet {...} dhe {...}.

Së fundi, pas përfundimit të tyre, kemi edhe zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 12.11.2020).

Në parantezë, lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore, në zbatim të protokolleve të miratuara, si edhe të Rregullores që Këshilli ka miratuar për shqyrtimin e hetimit disiplinor, kjo seancë dëgjimore do të zhvillohet pjesërisht në sallën që ne mblihdemi dhe pjesërisht “online”, për të mundësuar që të jenë të pranishëm Inspektorët, palët, por nga ana tjetër për të respektuar edhe protokollin e miratuar nga Komiteti dhe nga Ministria e Shëndetësisë, i cili ka të bëjë që të jenë jo më shumë se 10 vetë të grumbulluar brenda apo jashtë. Kështu që, një pjesë e kolegëve do jenë brenda në sallë, një pjesë e kolegëve të tjerë mund të na ndjekin përmes platformës “online” të zhvillimit të seancës dëgjimore.

Nëse jeni dakord, s’keni diskutime mbi rendin e ditës, sugjeroj që të fillojmë me shqyrtimin e çështjeve.

Kemi ndonjë gjë?

Nëse jo, kalojmë tek çështja e parë që ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, bëhet fjalë për procesverbalet e datave 24 shtator, 28 shtator, 30 shtator, 1 tetor, 2 tetor, 7 tetor, 9 tetor, 12 tetor (2 mbledhje), 13 tetor, 14 tetor, 15 tetor, 19 tetor, 20 tetor, 21 tetor (2 mbledhje) dhe 26 tetor.

Këto procesverbale ju janë vënë në dispozicion nga administrata.

Nëse keni ndonjë diskutim mbi procesverbalet, nëse jo, kalojmë në miratimin e tyre.

**Maksim Qoku:** Dakord, përveç procesverbalit të datës 09.10.2020, në të cilin nuk kam marrë pjesë në mbledhje.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro, përveç procesverbalit të datës 26.10.2020, ku nuk kam marrë pjesë, pasi kam qenë në mbledhje në Gjykatë të Lartë.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 24 shtator, 28 shtator, 30 shtator, 1 tetor, 2 tetor, 7 tetor, 9 tetor, 12 tetor (2 mbledhje), 13 tetor, 14 tetor, 15 tetor, 19 tetor, 20 tetor, 21 tetor (2 mbledhje) dhe 26 tetor.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.11.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor””, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relator z. Erjon Muharremaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:23.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu** (anëtare)
- 10. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 11. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor””, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relator z. Erjon Muharremaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me miratimin e “Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor”.

Në fakt ky është një akt shumë i rëndësishëm që ka ndërmarrë Këshilli në lidhje me transparencën dhe komunikimin me publikun.

Pa dashur të ndaloj gjatë, do doja t’ia jepja fjalën zotit Erjon Muharremaj, i cili është anëtar i përcaktuar nga Këshilli lidhur me komunikimet me publikun dhe median, gjithashtu anëtar i Komisionit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, prej të cilit ka ardhur si propozim ky projekt-akt.

Erjon, për ty fjala!

*Erjon Muharremaj:* Faleminderit, zonja Kryetare!

Jam shumë i kënaqur që kemi mbërritur në këtë moment, ku Këshilli i prezantohen sot dy akte shumë të rëndësishme, në funksion të asaj që ju përmendët, të përmirësimit të marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun, në funksion të rritjes së transparencës së veprimtarisë gjyqësore karshi publikut dhe të rritjes së besimit të publikut tek sistemi gjyqësor.

Është në fakt rrjedhojë e një pune të konsiderueshme; është një proces që ka kaluar nëpër disa faza, duke filluar edhe me fazën e një konsultimi të gjerë gjatë gjithë muajit qershor me gjykatat, për të kërkuar mendimin e tyre, mendime të cilat janë përfshirë një pjesë e tyre në projektin final që paraqitet sot për miratim, për të vijuar gjatë muajit korrik me konsultimet me të gjithë organet e medias dhe Organizata Jofitimprurëse, për të komentuar edhe ata, dhe për të përcjellë kontributet e tyre sa i përket këtyre dokumenteve shumë të rëndësishëm sepse krahas këtij projekt-akti “Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor”, një ndër pikat e tjera të rendit të ditës është edhe Rregullorja e komunikimit të Këshillit dhe janë që të dyja akte shumë të rëndësishme, që janë konsultuar; dhe për të kaluar më pas në një proces konsultimi edhe të brendshëm, veçanërisht bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe veçanërisht Projekti “Drejtësi për të gjithë” i USAID-it, të cilin gjej rastin ta falënderoj, meqë kemi prezent edhe përfaqësuesen e USAID-it sot në mbledhje. Dëshiroj të falënderoj për kontributin që kanë dhënë dy anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, znj. Kadi dhe znj. Ukperaj si dhe Këshilltaret Ligjore, znj. Taushani, znj. Palloj dhe znj. Shehu.

Në përfundim të një procesi të tillë të gjerë konsultimi, me qëllim garantimin e parimeve udhëheqëse të komunikimit të sistemit gjyqësor, sa i përket aksesit, komunikimit profesional, besueshmërinë, përgjegjësinë, transparencën, ndershmërinë, llogaridhënien si dhe angazhimin e Këshillit për rikthimin e besimit të publikut tek gjyqësori, janë përfshirë në këtë akt vizioni; misioni, vlerat thelbësore të gjyqësorit, qëllimet e komunikimit, parimet kryesore të komunikimit të gjyqësorit, roli i Këshillit dhe i gjyqtarit të medias, nëpunësit të marrëdhënive me median dhe publikun (që për shkurtim do i referohem në vijim si “nëpunësit”), bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës, roli i faqeve të internetit të gjykatave, roli i mediave sociale në zbatimin e parimeve të komunikimit, si dhe sfidat dhe mundësitë sa i përket komunikimit me publikun.

Hartimi i këtij plani strategjik ka për qëllim: Përcaktimin e bazave për përmirësimin e marrëdhënive të gjyqësorit me median dhe publikun; Garantimin e përmirësimit të aksesit, të kuptuarit dhe besimit të publikut tek gjykatat; Të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat;

Drafti paraparak i planit strategjik kaloi, siç thashë më parë, një proces të gjerë konsultimi.

Në përmbajtje të tij, në pjesën e parë të planit, parashikohen: Vizioni; Misioni dhe Vlerat thelbësore të gjyqësorit dhe është në fakt, vijim i të gjithë akteve të mëparshme sa i përket caktimit të anëtarit të ngarkuar për të mbajtur marrëdhëniet me publikun dhe të caktimit të gjyqtarëve të medias në çdo juridiksion apeli.

Tashmë ka filluara puna e rëndësishme për të përmirësuar marrëdhëniet me median dhe publikun dhe në pjesën e parë të Planit Strategjik i jepet rëndësi e veçantë vizionit dhe misionit të Këshillit, që kanë të bëjnë me:

Sa i përket vizionit - Drejtësia në Shqipëri do të arrihet kur të gjithë qytetarët janë të sigurt se ata do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në bazë të ligjit, nga një sistem gjyqësor që është i pavarur, etik dhe efikas.

Ndërsa sa i përket misionit, misioni i Këshillit është të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që kërkon përsosmëri dhe që meriton besimin e publikut.

Në këtë pjesë gjejnë pasqyrim edhe vlerat thelbësore të gjyqësorit, për të cilat Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykatat janë të angazhuara dhe janë përkushtuar për t'i përmbushur, sa i përket: Pavarësisë - ndërtimi i një gjyqësori që funksionon si një organ i pavarur, pa ndikim dhe i përkushtuar ndaj sundimit të ligjit; Integriteti - ndërtimi i një gjyqësori të ndershëm që funksionon sipas parimeve më të larta morale dhe etike dhe gjithmonë përpiqet të sigurojë drejtësinë; Profesionalizmi - ndërtimi i një gjyqësori, anëtarët e të cilit kanë të gjitha aftësitë e nevojshme për të kryer mirë rolet e tyre; Paanshmëria; Pavarësia; Profesionalizmi; Përgjegjësia dhe përtej këtyre vlerave thelbësore të Këshillit dhe të gjykatave, vendimmarrja e përditshme e gjyqësorit është e drejtuar nga këto parime të rëndësishme, si dhe: Aksesi, Efektiviteti, Efikasiteti, Barazia, Dinjiteti, Drejtësia, Besueshmëria, Respekti dhe Transparenca.

Në pjesën e dytë përmenden: Qëllimet e komunikimit; Monitorimi dhe shqyrtimi; Alokimi i burimeve; sepse Plan Strategjik për Sistemin Gjyqësor i miratuar nga Këshilli ka një nga objektivat e tij thelbësore, forcimin e marrëdhënieve midis gjyqësorit dhe publikut, ofrimin dhe zbatimin e mënyrave novatore dhe të përshtatshme për palët e interesit, në veçanti përmes sistemeve “online”, për rritjen e bashkëpunimit me to të



Këshillit, personelit administrativ dhe gjykatave; marrjen e një roli aktiv për të ndikuar në politikat publike dhe për të nxitur ndryshimet e duhura specifike, lidhur me mënyrën se si pushtetet e tjera ndër veprojnë me Këshillin, për planifikimin në sistemin gjyqësor; vendosjen e një strategjie komunikimi për të siguruar marrëdhënie transparente, proaktive dhe informuese me median dhe publikun; publikimin në kohë të vendimeve gjyqësore në portal dhe në faqen e internetit të KLGJ-së.

Po kështu, në pjesën e dytë të Planit gjejnë pasqyrim, monitorimi dhe shqyrtimi i reagimeve të drejtpërdrejta nga përdoruesit e gjykatave, publiku i gjerë, grupet e interesit, monitorimi i mediave, kryerja e sondazheve rreth perceptimit publik, analizën e të dhënave/statistikave të faqeve të internetit me qëllim:

Rritjen e ndërgjegjësimit për vizionin, misionin, qëllimet strategjike dhe veprimet e KLGJ; Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe të pjesëmarrjes së publikut në përcaktimin e prioriteteve të komunikimit të gjyqësorit; Rritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe të marrëdhënieve proaktive me mediat; Rritjen e koordinimit dhe efikasitetit të komunikimit të brendshëm.

Alokimi i burimeve, gjithashtu gjen pasqyrim në pjesën e dytë të planit strategjik, sa i përket burimeve njerëzore, financiare, teknike dhe institucionale të nevojshme për zbatimin e strategjive të komunikimit dhe arritjen e qëllimeve strategjike, burime këto që do të shpërndahen brenda kornizës së përcaktuar në këtë Plan Strategjik.

Proceset e përmirësuara të koordinimit të komunikimit të brendshëm, përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe bashkëpunimi me organizatat homologe në sistemin e drejtësisë, do t'i mundësojnë sistemit gjyqësor shqiptar të menaxhojë burimet në mënyrë më të efektshme dhe më efikase dhe të realizojë misionin e vet thelbësor, në përputhje me vlerat thelbësore të gjyqësorit.

Ndërsa në pjesën e tretë përfshihen parimet kryesore të komunikimit të gjyqësorit, ku futen ato që kanë të bëjnë me aksesin – e drejta e publikut për të vëzhguar procedurat gjyqësore dhe të kuptojë se çfarë ndodh në gjykatë, si funksionojnë gjykatat dhe si menaxhohet sistemi gjyqësor. Sado që duhet thënë, në kushtet aktuale të pandemisë, që ka prekur tërë rruzullin, jo vetëm Shqipërinë, aksesin i tillë është i kufizuar në mbrojtje të shëndetit publik edhe për të parandaluar përhapjen më të gjerë të pandemisë. Një nga

detyrat kryesore të nëpunësit me mbështetjen e gjyqtarit të medias është të sigurojë informacion dhe akses në masën më të madhe të mundshme, siç përcaktohet në ligj;

Përcaktohen Komunikimet Profesionale – Gjykata duhet të komunikojë profesionalisht, menjëherë dhe me mirësjellje, përmes Nëpunësit, ose nëse do të jetë e nevojshme, përmes Gjyqtarit të Medias ose Kryetarit të Gjykatës në raste të veçanta për çështje që kanë interes të lartë publik;

Besueshmëria – Trupa gjyqësore, Gjyqtari i Medias, Nëpunësi dhe personeli i gjykatës duhet të jenë të sinqertë me publikun dhe mediat, të japin sa më shumë informacion, siç përcaktohet në ligj, dhe nuk duhet të japin informacion sensitiv, konfidencial, apo që cenon veprimtarinë gjyqësore. Nëse ndodh gabimisht që të jepet informacion i pasaktë, ai duhet të korrigjohet sa më shpejt që të jetë e mundur;

Përgjegjësia - Gjykatat japin drejtësi në emër të Republikës dhe janë në shërbim të publikut. Gjyqtarët, administrata gjyqësore dhe administrata e KLGJ duhet të marrin përgjegjësinë për mirëmenaxhimin e gjykatave dhe burimeve të tyre në mënyrë profesionale. Gjykatat do të synojnë vazhdimisht për përsosmëri në trajtimin e dosjeve gjyqësore, përpunimin e çështjeve, mbajtjen e seancave dhe të sigurojnë që mjediset e gjykatës dhe informacionet gjyqësore të jenë lehtësisht të aksesueshme. Nëse ndeshin vështirësi, ato do të përpiqen të trajtojnë çështjen sa më shpejtë të jetë e mundur dhe me përgjegjësi.

Ndërsa në pjesën e katërt të Planit Strategjik përcaktohet roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor në zbatimin e parimeve të komunikimit.

Lidhur me zbatimin e parimit të aksesit, roli i Këshillit do të jetë: përcjellja e informacioneve veçanërisht nëpërmjet faqes së internetit, në të cilën duhet të përmbahen informacione të plota, informacione lidhur me të dhënat e kontaktit për Këshillin dhe gjykatat, përfshirë informacionin e kontaktit të zyrës së shtypit, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe lidhjet në të gjitha faqet e internetit të gjykatave shqiptare; Faqja e internetit duhet të jetë lehtësisht e përdorshme dhe të përfshijë informacion për Këshillin, veprimtarinë dhe vendimmarrjen e tij, njoftime të ndryshme, programin e transparencës, legjislacionin, informacionin për gjykatat dhe Gjyqtarët e Medias, informacion mbi të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, informacion mbi strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave në veçanti, mënyrën

dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, tarifat gjyqësore, etj; Gjykatat do të jenë në gjendje të krijojnë faqet e tyre të internetit të veçanta, ndërsa Këshilli duhet të sigurojë një model të unifikuar, në mënyrë që të gjitha faqet e internetit të gjykatave të kenë një pamje të ngjashme e të jenë lehtësisht të identifikueshme për publikun; Duhet gjithashtu të përmbajnë informacion për procedurat që duhen ndjekur për paraqitur kërkesë për informim, adresat postare dhe elektronike për dorëzimin e kërkesave për informim si dhe procedurat e ankimit të vendimit.

Lidhur me zbatimin e parimit të profesionalizmit, roli i Këshillit do të jetë përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të nëpunësit përgjegjës për marrëdhënien me median dhe publikun (NMMP), që do të përfshijnë:

Kthimin e përgjigjeve lidhur me kërkesat e paraqitura nga publiku dhe/apo media;

Mbikëqyrjen e përmbajtjes së faqes në internet për të siguruar që publiku të informohet në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore, si edhe për veprimet gjyqësore, oraret, shërbimet, etj.;

Hartimin e njoftimeve për shtyp në rastet që kanë interes të veçantë për publikun, kur oraret e gjykatës ose shërbimet ndryshojnë, kur një gjyqtar i ri caktohet në detyrë në mënyrë të përhershme në gjykatë, ose një gjyqtar del në pension, apo kur shtohet ndonjë program ose shërbim si dhe kur ka ndonjë aktivitet në të cilin publiku mund të marrë pjesë; si dhe ofrimin e shpjegimeve ndaj medias dhe publikut për të kuptuar procedurat gjyqësore dhe funksionimin e gjykatave.

Lidhur me zbatimin e parimit të besueshmërisë, vlen të theksohet se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka caktuar Gjyqtarët e Medias për çdo juridiksion apeli, bazuar në interesin e tyre për pozicionin, të kuptuarit prej tyre për rolin e medias dhe të komunikimit të tyre me gjykatat, aftësitë e tyre personale dhe të komunikimit publik. Gjithashtu Këshilli bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për të siguruar trajnimin e anëtarëve të Këshillit, të gjyqtarëve të medias, të administratës së Këshillit dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun.

Po kështu, roli i Këshillit në zbatimin e parimit të Përgjegjësisë, është sigurimi i fondeve për gjykatat për pagat e Nëpunësit për marrëdhëniet me median dhe publikun, të paktën në gjykatat më të mëdha, si dhe mjetet e nevojshme për informimin e publikut;

qartësimi i rolit të zyrës së shtypit të Këshillit, si dhe rolin e Gjyqtarëve të Medias dhe Nëpunësve; hartimi dhe përditësimi i listës së kontakteve, në mënyrë që të gjithë Nëpunësit të kenë mundësinë të komunikojnë nëpërmjet postës elektronike me njëritjetrin dhe me Gjyqtarët e Medias, nëse kanë nevojë për informacion apo këshilla, synojnë të organizojnë një aktivitet, apo kërkojnë kontributin e të tjerëve.

Në pjesën e pestë parashikohet roli i Gjyqtarit të Medias në zbatimin e parimeve të komunikimit.

Lidhur me zbatimin e parimit të sksesit, roli i Gjyqtarëve të Medias do të jetë:

Marrja e masave për publikimin në faqen e internetit të Këshillit dhe të gjykatave përkatëse, të informacionit rreth tyre pra rreth Gjyqtarëve të Medias; Të shpjegojnë procesit gjyqësore dhe ligjin e zbatueshëm në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për publikun; Të ilustrojnë vlerat kryesore të transparencës, profesionalizmit, besueshmërisë dhe llogaridhënies; Të organizojnë takime me përfaqësuesit e medias të paktën një herë në vit, për të dëgjuar problematikat e tyre, të diskutojnë për gjetjen e zgjidhjeve për to, për lehtësimin e raportimit të saktë të veprimtarisë së gjykatave dhe të informimit sa më të saktë e të shpejtë të publikut; Të jenë gjithmonë të hapur për komente dhe sugjerime për përmirësimin e punës së tyre.

Lidhur me zbatimin e parimit të profesionalizmit, Gjyqtarët e Medias do të caktohen që së bashku me kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët e tjerë të garantojnë dhe të sigurojnë besimin e kolegëve për cilësitë e tyre etike, aftësitë personale, aftësitë komunikuese, e kështu me radhë. Po kështu, KLGJ do të hartojë dhe përditësojë detyrat e Gjyqtarit të Medias, në mënyrë që ata të vlerësojnë pozicionin e tyre dhe të jenë në lartësinë e detyrës, të ndërgjegjshëm për pritshmëritë e medias dhe publikut ndaj tyre.

Lidhur me zbatimin e parimit të besueshmërisë, roli i Gjyqtarëve të Medias do të jetë: Të japin informacione të saktë dhe të plotë, sipas përcaktimeve të ligjit, duke përdorur një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme; Të marrin të gjitha masat për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale; Të jenë transparentë për veprimtarinë e sistemit gjyqësor.

Sa i përket parimit të përgjegjësisë, ata do të kenë detyrë që: të ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet Nëpunësve; të jenë të disponueshëm për Nëpunësit sapo të jetë e mundur; të mos përfshihen në zgjidhjen e një çështjeje me interes të veçantë publik,

por të jetë në dispozicion për të shpjeguar procedurat për median dhe publikun. Në rastet e çështjeve me interes të madh publik, Gjyqtari i Medias dhe Nëpunësi do të koordinojnë veprimtarinë e tyre ngushtësisht me gjyqtarin e çështjes dhe kryetarin e gjykatës, sa i përket marrëdhënieve me median, përfshirë: njoftimin nëse do të ketë vende të rezervuara, nëse do të lejohen kamerat, nëse mund të përdoren telefonat për komunikim dhe postime në mediat sociale nga sallat e gjyqeve, midis çështjeve të tjera.

Në pjesën e gjashtë të Planit Strategjik përcaktohet roli i nëpunësit për marrëdhënien me median dhe publikun në zbatimin e parimeve të komunikimit, ku ata shërbejnë si burimi kryesor i informacionit për median dhe publikun.

Në rastet kur ka zhvillime të lidhura me veprimtarinë e gjykatës, me interes për publikun, Nëpunësit do të bëjnë njoftime për të informuar median dhe publikun.

Ata duhet të bashkëpunojnë me personelin teknik për të siguruar që faqja e internetit e gjykatës është e lehtë për t'u përdorur dhe e konceptuar në mënyrë të tillë, që të mbajë parasysh kërkesat e publikut si dhe me qëllim përcjelljen në kohë të informacionit të drejtpërdrejt tek publiku.

Ata duhet të ndihmojnë për hartimin e një përmbledhjeje të rregullave të gjykatës në lidhje me aksesin e medias dhe publikut, të cilat duhet të jenë të përfshira në një dokument të vetëm, të thjeshtë, i cili është i disponueshëm në faqen e internetit të gjykatës.

Ata duhet të punojnë me çdo gjyqtar që gjykon një çështje me interes të veçantë publik, për të lehtësuar sa të jetë e mundur aksesin e medias dhe publikut, por gjithmonë duke respektuar rregullat në lidhje me ruajtjen e rendit dhe solemnitetit në mjediset e gjykatës. Kjo mund të nënkuptojë rezervimin e vendeve të veçanta për median dhe të tjera për publikun, duke siguruar që mikrofonat dhe qendrat e zërit në sallën e gjyqit janë funksionale dhe me volum të mjaftueshëm, etj.

Lidhur me zbatimin e parimit të profesionalizmit, roli i Nëpunësve do të jetë:

T'i përgjigjen sa më shpejt dhe saktë që të jetë e mundur, kërkesave të medias dhe publikut; Të zhvillojnë takime periodike me përfaqësuesit e medias; Të hartojnë përmbledhje të thjeshta, lehtësisht të kuptueshme nga publiku.

Sa i përket parimit të Besueshmërisë, roli i Nëpunësve do të jetë: Të sigurohen që informacioni është i saktë dhe i plotë; Të sigurohen se informacioni që publikon gjykata

në internet dhe rrjetet sociale është i përditësuar; Të mos japin informacione që përmbajnë të dhëna sensitive e konfidenciale.

Në pjesën e shtatë parashikohet roli i bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës në zbatimin e parimeve të komunikimit.

Lidhur me zbatimin e parimit të aksesit, Këshilli bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për të siguruar trajnimin e anëtarëve të Këshillit, të gjyqtarëve të medias, të administratës së Këshillit dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë. Në mënyrë të veçantë, trajnimi duhet të përfshijë rolin e transparencës sa i përket krijimit të besimit të publikut te sistemi gjyqësor; rëndësinë e një përgjigjeje të shpejtë, para se lajmi të përhapet gjerësisht; rëndësinë e gjykatave të hapura dhe që garantojnë akses; rolin e mediave sociale në ditët e sotme; rëndësinë e strategjisë së aksesit në publik;

Në pjesën e tetë parashikohet roli i faqeve të internetit të gjykatave. Veçanërisht në ditët e sotshme, të zhvillimeve teknologjike, lidhur me zbatimin e parimit të aksesit, gjykatat marrin të gjitha masat që informacioni në faqet e tyre të internetit të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme; faqet të jenë lehtësisht të përdorshme jo vetëm nga avokatët, por edhe nga publiku i gjerë; të jenë të aksesueshme informacionet edhe nëpërmjet telefonave celularë apo ndërmjet shfletuesve të ndryshëm të faqeve të internetit “broëser”, si “Chrome, Explorer, Firefox”, etj.

Gjithashtu, faqet e internetit të gjykatave duhet të përfshijnë: Informacion për të udhëzuar qytetarët që nuk përfaqësohen nga një avokat, se si duhet t’i drejtohen gjykatës për të nisur një proces gjyqësor; Informacion lidhur me aksesin në gjykatë, lidhur me ndihmën juridike, lidhur me procedurën e depozitimit dhe shqyrtimit të kërkesave për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore; informacion lidhur me afate të ndryshme, si dhe formularët që mund të plotësohen lehtësisht dhe dorëzohen gjithashtu nëpërmjet internetit.

Në pjesën e nëntë parashikohet roli i mediave sociale, veçanërisht të rëndësishëm në ditët e sotme të shpejtësisë së përhapjes së informacionit.

Lidhur me zbatimin e parimit të aksesit, Platformat e mediave sociale do të përdoren për të dhënë informacion në mënyrë të shpejtë edhe për ata që mund të mos kenë kompjuter ose akses në një faqe në internet, kur këto të fundit mund të jenë bllokuar për shkak të problemeve teknike, ose në raste emergjente. Kjo do të jetë një përpjekjeje e

përgjithshme për të transmetuar informacionin edhe për ata që nuk kanë njohuri me gjykatat dhe sistemin gjyqësor. Kështu për shembull mund të shfrytëzohen edhe videot në “YouTube” të cilat do të ofrojnë informacion të dobishëm rreth veprimtarisë së gjykatave.

Nëpërmjet këtij plani strategjik synohet t’i përcillet grupeve të interesit mesazhe kryesore, sa i përket publikut të gjerë përcjellja e mesazheve që sistemi gjyqësor është i pavarur dhe i paanshëm, garanton sundimin e shtetit të së drejtës dhe i shërben interesit publik dhe të gjithë personave pa dallime dhe sistemi gjyqësor duhet të gëzojë besimin e publikut, në mënyrë që t’i ofrojë atij siguri, nëpërmjet punës së tij të përditshme; duke folur me zë të qartë dhe të qëndrueshëm dhe duke dëgjuar me kujdes zërin e publikut;

Sa i përket medias, media dhe sistemi gjyqësor i shërbejnë së bashku interesit publik vetëm nëse ekziston bashkëpunimi i ndërsjellët dhe besim reciprok. Në këtë këndvështrim media konsiderohet partner kryesor në sigurimin dhe përcjelljen e informacionit në kohë të saktë dhe të plotë në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, pa cenuar pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e gjyqësorit.

Ky synim arrihet përmes komunikimit të strukturuar, të vazhdueshëm dhe proaktiv me median, duke informuar publikun më mirë për punën e sistemit gjyqësor.

Në lidhje me shoqërinë civile, Këshilli i Lartë Gjyqësor inkurajon komunikimin e dyanshëm midis shoqërisë civile dhe gjyqësorit për të promovuar vlerat themelore të pavarësisë gjyqësore, duke krijuar një bazë të dhënash me aktorët e ndryshëm të shoqërisë civile me të cilët të komunikohet në mënyrë të vazhdueshme, për çështje me interes për komunitetin që përfaqësojnë.

Sa i përket sektorit të biznesit, një sistemi gjyqësor i pavarur që i përmbahet besnikërisht sundimit të ligjit dhe nuk ndikohet nga politika ose presioni publik është shenjë dalluese e një demokracie të qëndrueshme dhe kontribuon gjithashtu në stabilitetin ekonomik. Pavarësia dhe paanshmëria e sistemit gjyqësor janë të rëndësishme në krijimin e besimit në sigurinë dhe parashikueshmërinë e transaksioneve ekonomike.

Sa i përket marrëdhënieve me organizatat homologe, Këshilli i Lartë Gjyqësor bashkëpunon me organizatat homologe që ndajnë qëllime të përbashkëta, adopton përvojat më pozitive të tyre, për të ruajtur dhe mbështetur pavarësinë dhe integritetin gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i përkushtuar që sistemi gjyqësor dhe shërbimet që ai ofron, të jenë në lartësinë e duhur, për të realizuar pritshmëritë e publikut.

Në lidhjen A, që i bashkëlidhet Planit Strategjik, pasqyrohet “Modeli i udhëzuesit standard të shtypit”, ndërsa në lidhjen B, përcaktohet “Model i njoftimit për shtyp”.

Së fundmi, dëshiroj të theksoj që ky Plan Strategjik, siç e përmenda edhe në fillim, nuk do të ishte bërë i mundur pa mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme të partnerëve tanë ndërkombëtarë, veçanërisht Projektit “Drejtësi për të gjithë” të USAID-it.

Në përfundim, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Miratimin e projektvendimit “Për planin strategjik të komunikimit për sistemin gjyqësor”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit Erjon, për prezantimin e detajuar, lidhur me përmbajtjen e Planit Strategjik.

Nëse nga kolegët kërkohet ndonjë diskutim, nëse jo...

**Brikena Ukperaj:** Më fal zonja Kryetare, sepse nuk doja t’i ndërhyja Erjonit.

Për shkak të një problemi që kisha me internetin, kam aksesuar gjatë relatimit të Erjonit lidhur relacionin e projekt-aktit, kështu që jam pjesëmarrëse në mbledhje. Nuk kam diskutim. Nuk kam komente lidhur me projekt-aktin, por doja të bëja me dije kolegët që kam hyrë me vonesë.

**Naureda Llagami:** Faleminderit Brikena!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në procesin e votimit të projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.



***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të miratojë “Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë e përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Kryetari, anëtari i Këshillit i caktuar për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, gjyqtarët e medias, nëpunësit për marrëdhëniet me publikun dhe mediat, me marrjen e masave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet njësia mbështetëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet me publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.11.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e modelit të hartimit të “Projekt-raportit të Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarit””, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relatore znj. Brikena Ukperaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:23.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>  | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e modelit të hartimit të “Projekt-raportit të Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarit”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relatore znj. Brikena Ukperaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me miratimin e modelit të hartimit të “Projekt-raportit të Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarit”. Për më shumë detaje, fjalën po ia jap (meqë është në linjë tashmë), zonjës Ukperaj, lidhur me prezantimin shkurtimisht të këtij projekt-raporti.

*Brikena Ukperaj:* Të nderuar anëtarë!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka miratuar një sërë aktesh nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve. Një nga këto akte është edhe vendimi nr. 263 datë 21.11.2019, me anë të së cilit janë miratuar rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve. Në këtë vendim është parashikuar që dy prej akteve të rëndësishme që finalizojnë punën e vlerësuesve, raporti analitik dhe projektraporti i vlerësimit, të përpilohen sipas një forme standarde, një modeli që duhet të miratohet nga Mbledhja Plenare. Me vendimin nr. 531, datë 28.10.2020, Këshilli ka miratuar modelin e hartimit të “Raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i mbështetur nga Njësia e Vlerësimit Profesional, po vazhdon punën për përfundimin e raporteve të para të vlerësimit. Nga puna e kryer deri tani si dhe bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5 të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohen elementët thelbësorë që duhet të përmbajë projektraporti i vlerësimit, është konkluduar në këtë model të formës standarde të projektraportit të vlerësimit që ju propozohet sot për miratim, bazuar në parashikimet e nenit 93 të Ligjit për Statusin dhe nenit 15 të Vendimit nr. 263 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Hartimi i modelit mbi bazën e të cilit do të hartohet projektraporti i vlerësimit nga relatori, ka për qëllim standardizimin e mënyrës së hartimit të tij, përfshirjen e të gjithë elementëve të domosdoshëm që duhet të përmbajë projektraporti sipas parashikimeve të nenit 93, pika 5 të Ligjit për Statusin si dhe përcaktimin dhe strukturimin e përmbajtjes për çdo pjesë të këtij projektraporti.

Modeli i projektraportit të vlerësimit është konceptuar si një dokument i integruar, i ndarë në shtatë pjesë (Ndarja A, B, C, D, E, F dhe G), si më poshtë:

Në ndarjen A të modelit të projektraportit gjëjnë vend dhe pasqyrohen të dhënat e gjyqtarit. Në këtë ndarje, në referim të nenit 93, pika 5, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, pasqyrohen të dhënat personale të gjyqtarit subjekt vlerësimi, të dhënat e kontaktit, gjykata në të cilën ushtron funksionin dhe, sipas rastit, seksioni përkatës, vlerësimi i mëparshëm, masa disiplinore nëse ka si dhe periudha e vlerësimit për të cilën hartohet raporti.

Ndarja B titullohet Vlerësuesi.

Në këtë ndarje pasqyrohen emrat e vlerësuesve të përzgjedhur me short, përkatësisht relatori dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

Ndarja C pasqyron qëllimin për të cilin hartohet projektraporti i cili konsiston në vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale të tij, propozimin për pikëzimin dhe përcaktimin e nivelit të vlerësimit për çdo kriter vlerësimi si dhe propozimin për pikëzimin dhe përcaktimin e nivelit përfundimtar të vlerësimit të gjyqtarit. Raporti përmban analizën e integruar dhe objektive të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, bazuar në përshkrimin e tyre në Raportin Analitik të hartuar nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin. Vlerësimi i

shkallës së aftësisë së gjyqtarit, propozimi për pikëzimin dhe përcaktimi i nivelit të vlerësimit për çdo kriter, referon në çdo rast, në parashikimet e Ligjit për Statusin dhe aktet nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit të gjyqtarëve.

Ndarja D titullohet Procedura.

Në këtë ndarje përshkruhen, në rend kronologjik, sipas dokumentacionit të ndodhur në dosjen e vlerësimit, të gjithë hapat procedurale të ndjekur në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, duke filluar nga momenti vendimmarrjes së Këshillit për fillimin e procedurës së vlerësimit, deri në momentin e hartimit të projektraportit të vlerësimit nga relatori. Dua të theksoj që ky është një element shumë i rëndësishëm të cilit i kemi kushtuar shumë vëmendje, duke marrë parasysh që analiza e detajuar e të gjithë elementëve të procedurës është e domosdoshme edhe sepse nëse gjyqtarët do të ankimojnë vendimin në Gjykatën e Apelit Administrativ, ky ankimim ndodh vetëm për shkelje të rënda të procedurës, sipas ndryshimeve ligjore që janë bërë në Ligjin për Statusin.

Në ndarja E gjen vend në mënyrë të detajuar analiza e integruar e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi.

Kjo ndarje e projektraportit të vlerësimit, është organizuar sipas katër grup kriterëve mbi të cilat bëhet vlerësimi etik dhe profesional i gjyqtarit dhe konkretisht:

Kriteri i parë “Aftësitë profesionale”;

Kriteri i dytë “Aftësitë organizative”;

Kriteri i tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe;

Kriteri i katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”.

Përmbajtja për secilin kriter, është organizuar mbi bazën e strukturës së Metodologjisë së Pikëzimit, duke përcaktuar për çdo tregues të katër kriterëve të vlerësimit, përmbajtjen e tij, në referim të përcaktimeve të nenit 93, pika 5, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: “Projektraporti i vlerësimit përmban: b) të dhënat e marra nga burimet e vlerësimit dhe analiza e tyre për vlerësimin e veprimtarisë së magjistratit, sipas kriterëve të vlerësimit”.

Për çdo tregues, përmbajtja e tij është organizuar në dy pjesë, ku pjesa e parë përmban analizën e integruar të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe

vlerësimin e tyre dhe, pjesa e dytë përmban propozimin për shkallën e aftësisë ose nivelin e treguesit dhe pikëzimin.

Pasqyrimi në projektraportin e vlerësimit e analizës së integruar, vlerësimi, propozimit për shkallën e aftësisë dhe pikëzimit, ndjek strukturën e përcaktuar në Metodologji.

Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale të gjyqtarit, është parashikuar se projektraporti duhet të përmbajë analizë të integruar të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësimin e aftësive të gjyqtarit në drejtim të komponentëve që përmban çdo tregues i këtij kriteri. Në vlerësimin e treguesve të këtij kriteri, relatori i referohet përshkrimit të të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit, sipas raportit analitik, por këto të dhëna analizohen në mënyrë të detajuar dhe integruar vetëm nga relatori. Më pas, pas analizës së integruar të të dhënave dhe vlerësimit në tërësi të tyre, për çdo tregues, evidentohet nga ana e relatorit në projektraport, shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe propozohet pikëzimi, referuar Metodologjisë së Pikëzimit.

E njëjta logjikë mënyrë konceptimi, përshkrimi dhe vlerësimi ndoqët edhe në lidhje me kriterin e aftësive organizative të gjyqtarit; kriterin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe kriterin e aftësive personale dhe angazhimit profesional, duke patur kujdes që aty ku ekziston një prezumim, pasqyrohen vetëm të dhënat që mund të çojnë në konkluzione të ndryshme.

Për të katërt kriteret e vlerësimit, në fund të tyre, pasqyrohet në modelin e projektraportit në formë tabelore, propozimi i relatorit për pikëzimin e kriterit përkatës dhe nivelin e vlerësimit.

Ndarja F përmban propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit. Kjo është një kërkesë që e parashikon neni 93 i ligjit.

Në këtë ndarje bëhet paraqitja në formë tabelore e propozimit të relatorit për pikëzimin dhe nivelin e vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit dhe më pas, propozimi për pikëzimin dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit për gjyqtarin, si pjesë e domosdoshëm e projektraportit të vlerësimit, sipas nenit 93, pika 5, shkronja “c”, të Ligjit për Statusin.

Ndarja G përmban propozime dhe rekomandime.

Në këtë ndarje relatori, në referim të nenit 93, pika 5, shkronja “ç” të Ligjit për Statusin, duhet të përcaktojë propozimet për trajnime ose rekomandimet për hapat e nevojshëm në drejtim të përmirësimit të veprimtarisë së gjyqtarit. Propozimet dhe rekomandimet vijnë si rezultat i të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në projektraport.

Ky projektraport shoqërohet nga Shtojca 1 e cila është pjesë integrale e projektraportit, ku në mënyrë të përmbledhur evidentohen të dhënat lidhur me kriteret e vlerësimit, shkallën e aftësisë, pikëzimin dhe nivelin e vlerësimit.

Projektraporti përmban këtë Shtojcë e cila është një format tabelor që përmban kriteret e vlerësimit, treguesit, shkallën e aftësisë dhe pikëzimin për çdo tregues e atë total, nivelin e vlerësimit për çdo kriter dhe nivelin e vlerësimit përfundimtar të gjyqtarit. Ky format tabelor, përveç sa më sipër, ka të integruar në të edhe të dhënat për metodologjinë e ndjekur në vlerësim, sipas rendit kronologjik të procesit vlerësues: shkallë aftësie-pikëzim-nivel vlerësimi.

Ky format tabelor, pjesë integrale e projektraportit të vlerësimit, është përmbledhje e përfundimeve që propozohen nga relatori në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit. Pas miratimit në tërësi apo me ndryshime të projektraportit nga Mbledhja Plenare, pjesa e Shtojcës 1 është lehtësisht e përdorshme në procedurat e promovimit të gjyqtarëve apo në çdo procedurë tjetër, për të cilën, pikëzimi dhe niveli i vlerësimit të gjyqtarit ka ndikim.

Për sa më sipër, në pikën e parë të projektvendimit është parashikuar miratimi i modelit të hartimit të “Projektraportit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, sipas formatit bashkëlidhur.

Në pikën e dytë të projektvendimit është parashikuar miratimi i modelit në formatin shkresor.

Vlen të theksohet që ky model hartimi projektraporti vlerësimi do të mbahet parasysh për aq sa është e mundur edhe në hartimin e projektraporteve të vlerësimit për efekte të gradimit të gjyqtarëve që kane kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në referim të nenit 97, shkronja “ç” dhe 98, pika 4 të Ligjit nr. 115/2016, është parashikuar hyrja në fuqi e këtij akti, në datën e publikimit në faqen e internetit të Këshillit. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zonja Ukperaj!  
Nëse kemi ndonjë diskutim për projekt-aktin? Ndryshe, kalojmë në miratimin e tij?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e modelit të hartimit të “Projektraportit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Modeli i “Projektraportit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit” miratohet në formatin shkresor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.11.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e Rregullores “Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median””, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relator z. Erjon Muharremaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:23.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e Rregullores “Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median””, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relator z. Erjon Muharremaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me miratimin e Rregullores “Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median”. Sërish për këtë projekt-akt, ia jap fjalën zotit Muharremaj. Do i kërkoja në fakt që shkurtimisht të bënte një prezantim, duke qenë se me projekt-aktin jemi njohur që të gjithë. Duke parë dhe kohën që duhet të përfshihemi në seancën dëgjimore.

*Erjon Muharremaj:* Faleminderit, zonja Kryetare!

Në vijim të aktit të mëparshëm Planit Strategjik të komunikimit, është përgatitur edhe Rregullorja “Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median”, që synon:

1. Përcaktimin e parimeve, rregullave dhe procedurave të veçanta për marrëdhëniet me publikun të Këshillit
2. Komunikimin e ligjshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional të Këshillit me median e shkruar dhe elektronike, si dhe me çdo përfaqësues të saj, si dhe;
3. Lehtësimin e vështirësive për aksesimin e lajmit për komunitetin e mediave dhe gazetarëve.

Komunikimi në kuptimin e kësaj rregulloreje, përfshin të gjitha mënyrat e vendosjes së kontakteve institucionale ndërmjet Këshillit dhe medias, si dhe shkëmbimin e informacionit në formë teksti, figurash, videosh apo të dhënash.

Në mënyrë të përmbledhur organizimi i Rregullores është i tillë, ku në Kreun e I janë përcaktuar dispozitat e përgjithshme për komunikimin me median dhe konkretisht, në nenin 1 të projektregullores përcaktohet objekti i rregullores që konsiston në përcaktimin e parimeve, rregullave dhe procedurave të veçanta.

Në nenin 2 përcaktohen përkufizimet për termat e përdorura në vendim.

Në nenin 3 përcaktohet fusha e veprimit të dispozitave të Rregullores.

Në nenin 4 përcaktohen parimet në të cilat bazohet dhe zbatohet komunikimi me median dhe publikun, ku përfshihen: Parimi i objektivitetit, llogaridhënies, profesionalizmit, besueshmërisë, ndershmërisë dhe mirëbesimit, të raportimit korrekt të lajmit.

Në Kreun II parashikohet komunikimi me median. Ky Kre përbëhet nga 5 nene që strukturojnë procedurën e komunikimit me median.

Në nenin 5 të projektregullores përcaktohet se kontaktet e Këshillit me përfaqësuesit e medias do të mbahen nga Koordinatori për të drejtën e informimit, sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrjen e anëtarit të caktuar të Këshillit, i cili miraton informacionin që i përcillet medias.

Sa i përket faqes zyrtare të Këshillit, në të do të ekzistojë një rubrikë e veçantë me emërtimin “Kontakti me median” dhe vendosja e kontaktit dhe komunikimi i mëtejshëm me median do realizohet nëpërmjet një adrese të posaçme të postës elektronike të e-mailit [media@klgj.al](mailto:media@klgj.al), e cila përdoret nga Koordinatori për të drejtën e informimit.

Në nenin 6 të projektregullores përcaktohet procesi për trajtimin e kërkesave, ku anëtari i caktuar i Këshillit mbikëqyr të gjithë procedurën e brendshme të pranimit dhe trajtimit të kërkesave dhe mbajtjes së kontakteve me median dhe Këshilli trajton kërkesën për informim duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por gjithmonë, jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj. Ky afat mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune në rastet kur kërkohen apo shqyrtohet informacion dhe dokumentacion shumë voluminoz; kur lind nevoja për të shtrirë kërkimet pranë

gjykatave; kur ka nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Në nenin 7 të projektregullores përcaktohen lehtësitë për aksesin në informacion nga media dhe në pikën 1 të nenit 7 parashikohet se Këshilli zhvillon dhe mirëmban një portal elektronik në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për çështjet me interes publik. Në pikën 2 të nenit 7 përcaktohet se mediat kanë të drejtë të kenë një përfaqësues të akredituar pranë Këshillit, i cili nënshkruan një deklaratë sipas të cilës angazhohet për trajtimin e informacionit të marrë nga Këshilli në përputhje me kërkesat profesionale dhe parimet e kësaj Rregulloreje. Akreditimi i mediave të huaja bëhet pas akreditimit të tyre nga Ministria e Jashtme, sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave. Në pikën 3, 4 dhe 5 të nenit 7 parashikohet se çdo kërkesë për informacion duhet t'i drejtohet Koordinatorit për të drejtën e informimit.

Në nenin 8 të projektregullores është normuar pasqyrimi në media i mbledhjeve plenare të Këshillit. Në pikën 2 të nenit 8 përcaktohet se përfaqësuesit e medias që dëshirojnë të marrin pjesë në mbledhjen plenare të Këshillit, duhet të paraqesin dokumentin e akreditimit personal dhe të identifikimit të medias që përfaqësojnë. Në pikën 3 të nenit 8 përcaktohet ndalimi i regjistrimit audio-vizuale të mbledhjeve të Këshillit, pa autorizimin paraprak të tij. Në pikën 4 të nenit 8 përcaktohet se komunikimi i përfaqësuesve të medias gjatë zhvillimit të mbledhjes duhet të jetë etik dhe profesional. Në pikën 5 të nenit 8 përcaktohet se përpara fillimit të mbledhjes, Anëtari i caktuar i Këshillit udhëzon Koordinatorin për të drejtën e informimit në lidhje me mundësinë e kryerjes së fotografive dhe filmimeve dhe kohëzgjatjen e tyre. Në pikën 6 të nenit 8 përcaktohet se në interes të zhvillimit të rregullt të mbledhjes, regjistrimet vizuale lejohen vetëm nga një pozicion i caktuar në sallë, sipas udhëzimeve të Koordinatorit për të drejtën e informimit. Në pikën 7 të nenit 8 përcaktohet se Këshilli do të monitorojë zbatimin korrekt të rregullave të komunikimit me median.

Në nenin 9 të projektregullores është parashikuar edukimi i medias dhe publikut, duke zhvilluar aktivitete të përbashkëta me median dhe organizatat partnere sa i përket edukimit profesional të mediave dhe publikut.

Në pikën 7 të nenit 9 përcaktohet se Anëtari i caktuar i raporton Këshillit mbi zbatimin e Strategjisë së Komunikimit.

Në lidhjen 1, bashkëlidhur Rregullores bashkohet edhe “Formulari i aplikimit për lehtësira për median” dhe bazuar në të gjithë këto Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Miratimin e Rregullores “Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, Erjon!

Nëse s’kemi diskutime kalojmë në procedurën e miratimit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të miratojë Rregulloren “Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median”, sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë e përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Kryetari, anëtari i Këshillit i caktuar për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun dhe Njësia Mbështetëse për Marrëdhëniet me Publikun dhe Botimet, me marrjen e masave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Njësia Mbështetëse për Marrëdhëniet me Publikun dhe Botimet me publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.11.2020)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:23.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 8. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor. Shkurtimisht, në linjë kemi zonjën Laze, e cila do na shpjegojë arsyet e propozimit të këtij projekt-akti nga Komisioni i Planifikimit Strategjik.

*Luljeta Laze:* Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të detyrave të saj për menaxhimin e buxhetit të shtetit, pas vlerësimeve që ka bërë për përdorimin e buxhetit për vitin 2020, kërkon të bëjë shkurtime të këtij buxheti, por paraprakisht ka kërkuar edhe konfirmimin, besoj të gjithë institucioneve, në këtë mënyrë ka kërkuar edhe konfirmim të institucioneve që i ka vlerësuar si të lira për sistemin gjyqësor, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Me marrjen e kësaj kërkesë, struktura përgjegjëse, ka analizuar edhe një herë buxhetin dhe në analizë janë marrë parasysh sigurisht buxheti i alokuar prej fillimit të vitit ndryshimet që ai ka bërë dhe realizimin e deritanishëm. Realizimi i deritanishëm është konfirmuar për KLGJ-në nga dega e thesarit të Tiranës dhe për përdorimin e



buxhetit të gjykatave janë marrë konfirmimet nga secila prej gjykatave për mundësinë e përdorimit të tyre. Prej këtyre fondeve është e dukshme ato që janë fonde të lira që vijnë kryesisht nga mungesa e burimeve njerëzore në të gjithë sistemin dhe në funksion të këtyre analizave, sikurse shpjegova, propozohet ky shkurtim i fondeve.

Nga buxheti i KLGJ-së sugjerohen si fonde të lira shuma prej 11 milion lekë e cila është e tëra në shpenzime personeli, nga të cilat 5 milion lekë janë në shpenzime për paga dhe 6 milion lekë në sigurime shoqërore. Sikurse e thashë, shkak është vendet vakante akoma të paplotësuara.

Nga programi i buxhetit të gjykatave sugjerohen fonde të lira në shumën 153 milion lekë, nga të cilat 141 milion lekë janë në shpenzime personeli dhe këto të ndara përkatësisht 135 milion lekë në paga dhe 6 milion lekë në sigurime shoqërore. Arsyeja e fondeve të lira është e njëjtë (nga mungesa e burimeve njerëzore). Gjithashtu janë propozuar edhe si fonde të lira 12 milion lekë në shpenzime operative. Këto janë fonde që janë mbajtur në programin e buxhetit të gjykatave për përdorim në KLGJ dhe këtu përfshihet një fond që është mbajtur për ruajtjen dhe sigurinë e shëndetit për gjyqtarët e gjykatave të posaçme, i cili ka qenë një fond i programuar dhe i mbajtur në dispozicion, të pritjes së një vendimi përkatës, pasi kjo ka qenë një e drejtë që gjyqtarët në gjykatën e posaçme e kanë pasur dhe mendohej që me vendim qeveri do të ribëhej. Meqenëse ky vendim tashmë nuk ka dalë, këto mbeten si fonde të lira. Gjithashtu janë fondet e lira që rezultojnë për shkak të likuidimit të faturës muaji dhjetor në shërbimin e sigurisë fizike të gjykatave sepse sikurse e dimë edhe kontrata është deri më 31 dhjetor dhe për likuidimin e kësaj fature ne kemi hartuar një procedurë që e kemi të nënvizuar edhe në aktin e nënshkrimit (në kontratën që kemi nënshkruar midis palëve), ku duhet të merret një konfirmim i plotë, i qartë nga të gjithë gjykatat për shërbimin e kryer dhe kjo kërkon kohën e vet.

Në këto kushte, fondet që propozohen si të lira janë qartësisht që nuk do të përdoren më gjatë këtij viti, pra për periudhën e mbetur të vitit 2020.

Në përfundim, kërkohet miratimi për fonde të lira në buxhetin e vitit 2020 , në shumën 164 000 000 lekë, nga të cilat KLGJ-ja 11 000 000 lekë (sikurse shpjegova në shpenzime personeli e ndarë në paga dhe sigurime) dhe nga buxheti i gjykatave 153 000

000 lekë (të shpërndara në shpenzime personeli 141 milion dhe shpenzime operative 12 milion lekë). Ky ishte akti. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e tij, në procedurë miratimi?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në sistemin gjyqësor, si më poshtë:

-në programin 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i KLGJ-së, për shumën prej 11 000 000 (njëmbëdhjetë milion) lekë, sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur.

-në programin 03310, “Buxheti gjyqësor” buxheti i Gjykatave, për shumën prej 153 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e tre milion) lekë, sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur.

2. Fondet e lira të miratuara, t’i konfirmohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të rishikimit të Buxhetit të Shtetit.

3. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**Kryetare**

**Naureda Llagami**

**Specialiste**

**Rosalba Xhabrahimi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.11.2020)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:23.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap z. Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Atëherë, në lidhje me projektvendimin që ju është paraqitur për shqyrtim që ka të bëjë me përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}, ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues që ka lidhje me këtë projektvendim. Shkurtimeisht mund t’ju them se zonja {...} ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe për pozicionin në fushën e së drejtës penale, shpallur me vendimin nr. nr. 243, datë 09.07.2020.

Në këtë rast, lidhur me kandidimet e zonjës {...}, Këshilli ka filluar procedurën e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, ndër ta edhe për zonjën {...}, me vendimin nr. 268, datë 07.08.2020.

Në këtë rast, pas shortit të hedhur, si relator për procedurën e verifikimit të zonjës {...} jam caktuar unë.

Në relacion shpjegohen të gjitha veprimet e kryera nga unë si relator dhe procedurat e ndjekura. Mund t'ju them që më herët Këshilli, me vendimin nr. 323, datë 17.09.2020, ka vendosur: Verifikimin e plotësimit të tre kritereve formale për zonjën {...}, lidhur me kandidimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, por mbas këtij vendimi rezulton se KPK me Vendimin nr. 307, datë 12.10.2020, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të znj. {...}”.

Mbas këtij momenti, zonja {...}, më datë 10 nëntor 2020 ka depozituar pranë Këshillit një kërkesë me shkrim përmes të cilës hiqte dorë nga kandidimi i saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Në këtë situatë është përgatitur edhe relacioni dhe projektvendimi përkatës, ndërsa konsiston në disponimin nga ana e Këshillit të përfundimit të procedurave të ngritjes në detyrë për znj. {...} nga dy kandidatimet e saj në Gjykatën e Lartë.

Në përfundim, në cilësinë e relatorit, ju parashtoj edhe propozimin sipas projektvendimit që është objekt shqyrtimi në mbledhjen e KLGJ-së, nëpërmjet të cilës i propozohet Këshillit që të vendosë përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Nga kolegët ka diskutime? Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.11.2020)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:23.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)



**Shënim:** Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban {...}*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}”, përparitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës. Përpara se të kalojmë në shqyrtimin e tij, do ftoja zotën {...} të largohej nga diskutimi dhe shqyrtimi i projekt-aktit.

*Alban {...}:* Po, dakord!

*Naureda Llagami:* Atëherë, projekt-akti i radhës ka të bëjë me përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}. Relatore e projekt-aktit është znj. Marçela Shehu. Marçela për ty fjala. Shkurtimisht të lutem.

*Marçela Shehu:* Faleminderit, Kryetare!

Gjyqtarja, kandidatja {...} ka kandiduar për disa pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, konkretisht për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, shpallur me vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020 si dhe për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës administrative të shpallura përkatësisht me vendimet e Këshillit nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020.

Për këtë kandidate është realizuar procedura e verifikimit të kriterëve formale dhe me vendimin e Këshillit nr. 328, datë 17.09.2020, Këshilli ka vendosur verifikimin e plotësimit nga kandidatja të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” lidhur me pozicionet për të cilat ajo ka kandiduar.

Aktualisht kandidatja është në procedurë vlerësimi profesional dhe etik, procedurë e cila po zhvillohet paralelisht dhe me procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të figurës të kësaj kandidateje.

Ndërkohë, zonja {...}, me shkresën e paraqitur para KLGJ-së protokolluar me nr. 5508, datë 28.10.2020, ka shprehur vullnetin e saj mbi tërheqjen nga kandidimi për të tre pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.

Në këto kushte, me cilësinë e relatores, në referim të vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, kam përgatitur relacionin dhe projekt-aktin përkatës, me anë të të cilit i propozohet Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për këtë kandidate për të tria pozicionet që ajo ka kandiduar. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për kandidaten zonjën {...}, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës

civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, për shkak të tërheqjes nga kandidimi.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq mbaruam çështjet që kishim për diskutim, por jo mbledhjen.

Ashtu sikurse jua referova edhe në fillim të mbledhjes, do kalojmë në zhvillimin e seancës dëgjimore. Unë do propozoja që të paktën, anëtarët e Komisionit të Disiplinës të jenë prezent në sallë dhe gjithsej, bashkë me mua bëhen 4 vetë. Edhe një anëtar tjetër, kush është vullnetar, mund të vijë në sallë, duke i lënë mundësi më pas që të kemi 2 përfaqësime nga palët (magjistrati) dhe 2 përfaqësues nga Inspektori. Jemi dakord?

(Anëtarët janë dakord.)

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.11.2020)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 12.11.2020).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:23.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>  | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë.*
- 6. Periant Teta, Këshilltar pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.*
- 8. Marçela {...}, përfaqësuese ligjore e magjistratit {...}.*
- 9. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 11. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 12.11.2020).

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Kalojmë tek çështja e rendit të ditës që ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, shtyrë kjo nga mbledhja plenare e datës 12 nëntor 2020.

Në radhë të parë, ju kërkoj ndjese për vonesën dhe kjo vjen nga fakti që nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndryshimit të protokolleve të zhvillimit të mbledhjeve, kemi mundësuar që sot mbledhjen ta bëjmë pjesërisht në sallën tonë dhe pjesërisht në “online”. Pra një pjesë e anëtarëve të cilët janë në pamundësi për shkak të protokollit për të qenë në këtë sallë, i kemi “online” dhe këtë gjë na e mundëson edhe Rregullorja që kemi miratuar, e cila ka të bëjë me procedurat disiplinore në Këshillin e

Lartë Gjyqësor, ku lejon që anëtarët e Këshillit mund ta ndjekin seancën dëgjimore edhe “online”.

Atëherë, pa dashur të humbasim më kohë, siç jeni në dijeni, çështja vijon nga seanca plenare e datës 12 nëntor 2020. Në këtë seancë, magjistrati nën procedim z. {...} nuk u paraqit duke njoftuar Këshillin e Lartë Gjyqësor se ishte karantinuar në banesë për shkak se bashkëshortja dhe përfaqësuesja e tij ligjore në këtë proces, ka rezultuar pozitiv me COVID-19.

Duke marrë në konsideratë këtë situatë, Këshilli bëri shtyrjen e seancës për ditën e sotshme dhe ka njoftuar palët nëpërmjet adresës elektronike dhe sot janë prezent.

Siç e dimë, në seancën pararendëse, atë të datës 5 nëntor, Këshilli vendosi t’u japi mundësi palëve për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes personale të magjistratit z. {...}, që administrohet nga Departamenti i Burimeve Njerëzore në Këshill, në funksion të shqyrtimit të drejtë, me objektivitet dhe të plotë të çështjes.

Atëherë, pa humbur kohë çelim vazhdimin e seancës dëgjimore.

Verifikohen prezenca e palëve. Nga ana e Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë ka ardhur vet zoti Inspektor i Lartë, Artur Metani.

**Artur Metani:** Dhe Këshilltari Periant Teta.

**Naureda Llagami:** Dhe nga ana e gjyqtarit nën procedim?

{...}: Gjyqtari {...} dhe mbrojtësja, avokatja Marçela {...}.

**Naureda Llagami:** Atëherë, siç jeni në dijeni, nga ana e subjektit/magjistratit është përcjellë një kërkesë Këshillit e cila ka të bëjë me kërkesën për administrim, në cilësinë e provës, praktikën e plotë që i përket këtij procedimi disiplinor, referuar, që ka të bëjë me vendimin nr. 89, datë 07.07.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kjo është kërkesa që ju keni parashtruar Këshillit sot nëpërmjet parashtrësës.

{...}: Po, e nderuar Kryetare!

Por paraprkasht, për të qenë në rregull me procedurën, siç e kam parashtruar, kam depozituar në rrugë elektronike, dy vërtetime që vërtetojnë situatën e karantimit (vërtetimet zyrtare), të cilat kërkoj të administrohen nga ana e Këshillit në origjinal (sepse janë përcjellë në rrugë elektronike). Janë: Vërtetimi i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Korçë, me nr. 61 dhe 62 prot., të datës 19.11.2020, për shtetasen Marçela {...} dhe shtetasin {...}, ku vërtetohet zyrtarisht periudha e karantinimit, sipas ligjit për këtë qëllim procedural të procesit.

Njëkohësisht kam përcjellë në rrugë elektronike, ditën e djeshme, përveç kërkesës që është depozituar (që ju e parashtruat), edhe parashtrësën që mbështet arsyen e kërimit. Kërkoj që edhe kjo parashtrësë të administrohet në formë shkresore në këtë seancë. Mund t'i depozitoj.

***Naureda Llagami:*** Dakord! Atëherë, shkurtimisht, lidhur me kërkimin tuaj.

***Markelain {...}***: Shkurtimisht, do flasë avokatja.

***(Avokatja):*** Faleminderit!

Siç kemi parashtruar në kërkesë, pasi u njohëm me aktet, pjesë të dosjes personale, administruar kryesisht nga ana juaj, edhe pse nuk u njohëm me arsyen e administrimit kryesisht nga ky Këshill dhe që bie ndesh me parimet e një procesi të rregullt ligjor, të pavarësisë, të paanësisë të institucionit disiplinor dhe kryesisht me parimin e drejtësisë së hapur, jam e detyruar të sqaroj si më poshtë:

Konstatoj se dosja e administruar në seancën e datës 21 tetor nga ana e këtij Këshilli nuk është e plotë, pasi mungon praktika e plotë e procedimit disiplinor, finalizuar me vendimin nr. 89, datë 07.07.2014. Për rrjedhojë, kemi kërkuar të administrohen në cilësinë e provës ... (*audio ndërpritet*) e këtij procedimi disiplinor. Duke sqaruar shkurtimisht për këtë se: Jemi detyruar të bëjmë këtë kërkim referuar momentit procedural ku nga ana e këtij Këshilli u vendos kryesisht administrimi si provë e vendimit nr. 89, datë 07.07., i Këshillit të Lartë të Drejtësisë edhe pse në seancën dëgjimore, nga ana jonë, u pretendua se kjo dosje nuk është e plotë. Diskutimi në mbledhjen e datës 07.07. ka qenë komplet në tjetër drejtim. Procesverbali i mbledhjes nuk është publikuar

asnjëherë në faqen e KLD-së dhe vendimi 89, 07.07. është finalizuar me “rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës disiplinore”, ndërsa pjesa arsyetuese dhe përshkruese e tij, vjen në kundërshtim të hapur me pjesën urdhëruese të tij. Mjaftonin këto fakte, të relatuar në seancën e kaluar nga ana e gjyqtarit, për të bërë që ky Këshill të administronte kryesisht dhe të hetonte kryesisht dhe në këtë pjesën e këtij hetimi disiplinor.

Së dyti, pasi jemi njohur me praktikën e plotë të procedimit disiplinor dhe të dosjes së administruar nga ana juaj, konstatojmë se dosja nuk ka qenë e plotë. Ndërsa praktika, në momentin që jemi njohur me praktikën e procedimit disiplinor, jemi njohur vetëm në këtë moment dhe me procesverbalin e mbledhjes së datës 07.07., pasi ky procesverbal nuk është publikuar asnjëherë në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Së treti, nisur nga fakti që kur vendimi është administruar kryesisht nga ana e KLGJ-së në dosje personale, pa u relatuar shkaqet, duke aluduar që shkaku kryesor për administrimin e kësaj prove ka qenë vendimi 89, jemi të detyruar që të sqarojmë se, me këtë vendim është vendosur: “Rrëzimi i kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” dhe mbylljen e procedimit të mëtejshëm disiplinor ndaj gjyqtarit {...}”. Çka do të thotë se ndaj gjyqtarit, në kuadër të këtij procedimi disiplinor, nuk ka asnjë masë disiplinore, sa kohë që me vendim të një organi kolegjial është vendosur mbyllja e këtij procedimi disiplinor, me të gjitha votat e anëtarëve prezent në mbledhje.

Duke u referuar faktit që në seancën e kaluar u lexuan pjesë të shkëputura nga vendimi nr. 89, duke tentuar dukshëm që të rëndohet pozita e gjyqtarit në kuadër të procedimit disiplinor aktual dhe në dukje faktin se vendimi nr. 89 është një vendim përfundimtar, i paankimueshëm me në një vendim kolegjial dhe si i tillë ka fuqinë e ligjit për këdo, për rrjedhojë edhe për këtë Këshill. Nëse ky Këshill vendos dhe ka tagrin të vlerësojë edhe këtë vendimmarrje në çdo aspekt të saj, fillimisht duhet të shtojë objektin e procedimit disiplinor dhe më pas të saktësojë shkaqet dhe arsyet e marrjes në vlerësim prej tyre të vendimit nr. 89. Nëse ky Këshill vendos dhe ka tagrin të marrë në vlerësim këtë vendimmarrje, duhet ta bëjë pasi të administrojë të plotë dosjen personale të gjyqtarit



dhe jo vetëm një pjesë të kësaj dosjeje, administrimi i të cilës kryesisht vë në dukje qëllimin haptazi joligjor dhe procedural të rëndimit pa shkak të pozitës së gjyqtarit.

Nisur nga fakti se në seancën e datës 21.10., pasi u cituan pjesë të shkëputura të këtij vendimi dhe më pas u vendos administrimi kryesisht i tij si provë, jam e detyruar të parashtoj qëndrimin tim sa i takon këtij momenti.

Në përgjigje të pyetjes së zotit Muharremaj, gjyqtari sqaron për këtë Këshill fakte të cilat kishin të bënin me atë procedim disiplinor, duke relatuar në mënyrë të hollësishme atë situatë, pavarësisht kohës së gjatë të kaluar. Kjo bën që të ngelet pa vend referimi tek vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit kërkuesi duhet të jetë në dijeni për procedurat para tij kur kanë të bëjnë me shkelje të pretenduara. Gjithashtu, faktet se gjyqtari sqaroi në mënyrë të hollësishme situatën e atëhershme, bëjnë që të ngelet i pavend edhe referimi i zotit Muharremaj tek përcaktimet e ligjit për statusin e gjyqtarëve, neni 115, pika “ç”, sa kohë që me vendim nr. 89, është vendosur mbyllja e procedimit disiplinor të mëtejshëm, pa asnjë masë disiplinore ndaj gjyqtarit.

Duke u ndalur tek citimi që u bë tek paragrafi 10/2 të vendimit nr. 89 të ish-KLD-së, sqarojmë për këtë Këshill se ky paragraf i cituar, i shkëputur, i nxjerrë nga konteksti, me qëllim për të rënduar pozitën e gjyqtarit, nuk ka qenë konkluzion i mbledhjes së KLGJ-së, por është përfshirë në pjesën arsyetuese të këtij vendimi si pjesë e parashtrimit të Ministrit të Drejtësisë. Ky paragraf referon tek shkresa datë 27.06.2013, me të cilën, nga ana e Inspektoratit të KLD-së është vendosur “tërheqja e vëmendjes me shkrim” për gjyqtarin {...}, duke mbajtur në konsideratë në rast përsëritjeje në të ardhmen.

Duke u ndalur tek ky paragraf, siç u sqarua herën e kaluar në seancën e datës 21 me gojë nga gjyqtari, kjo vërejtje është kontestuar nga ana e atij në atë kohë, por detyrohemi të sqarojmë edhe një herë se kjo vërejtje nuk është vendimmarrje e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për rrjedhojë nuk është masë e dhënë në kuadër të një procedimi disiplinor nga organi kompetent. Në vetvete kjo vërejtje ka qenë joligjore dhe e kontestueshme, ndaj edhe kjo pikë e Rregullores së KLD-së, në një kohë të mëvonshme është shfuqizuar.

Duke u kthyer tek theksi që në këtë seancë iu vu kësaj vërejtjeje, duke tentuar të paraqitej si rast i përsëritur, ritheksojmë se kjo mënyrë e dhënies së kësaj vërejtjeje është bërë pjesë e diskutimit në atë mbledhje të KLD-së. Por ky diskutim që është bërë në atë

mbledhje të KLD-së, për mënyrën e dhënies së kësaj vërejtjeje, nuk është pasqyruar aspak në vendimin nr. 89, as në pjesën përshkruese dhe as në pjesën arsyetuese.

Parë qëndrimin e mbajtur në seancën dëgjimore të datës 21.10., jemi detyruar të citojmë pjesë të këtij procesverballi. Në atë mbledhje, gjatë diskutimit që është bërë në prezencë të gjyqtarit, zoti Hysen Saliko, anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka parashtruar: “Ministri i Drejtësisë, për të konsideruar shkeljen tuaj të përsëritur, ka sjellë edhe një rast nga Zëvendëskryetari i KLD-së, nëpërmjet Kryeinspektore, ju është tërhequr vëmendja për këtë shkelje”, -duke i kërkuar gjyqtarit të parashtrrojë qëndrimin e tij” - (pasqyruar kjo në faqen 21 të procesverballit).

Në vijim, KLD, pasi ka dëgjuar gjyqtarin, është tërhequr pa prezencën e tij.

Pasi u njohëm me procesverbalin e mbledhjes, kemi konstatuar se diskutimet e asaj mbledhjeje kanë qenë në atë linjë, siç gjyqtari sqaroi herën e parë, komplet të ndryshme nga mënyra sesi është arsyetuar vendimi nr. 89. Konkretisht zoti Gjin Gjoni ka parashtruar në atë mbledhje se: “...Në lidhje me momentin e tërheqjes së vërejtjes, me të drejtë gjyqtari përmendi, tërheqja e vëmendjes nuk është një masë disiplinore... A mundet, Kryeinspektorja bashkë me Nënkryetarin e Këshillit në bazë të Rregullores, të tërheqin vëmendje? ... Ne kemi raste që gjyqtarëve që u është tërhequr vëmendja dy herë, tre herë, edhe katër herë dhe nuk janë prurë përpara Këshillit për shkarkim. Në qoftë se do e marrim në sensin e rasteve të përsëritura, për mendimin tim, ky nuk është rast i përsëritur. Për sa kohë që Rregullorja përcakton masat disiplinore në mënyrë taksative...” - (pasqyruar ky paragraf në faqen 22 të procesverballit).

Zoti Hysen Saliko, kur ka rimarrë fjalën ka diskutuar në Këshill: “...nuk kemi të bëjmë me një rast të përsëritur. Tërheqja e vëmendjes nga ana e Inspektoratit apo nga ana e Zëvendëskryetarit nuk shërben dhe nuk mund të shërbejë dhe të jetë indicie për të nisur një procedim disiplinor. Vet Rregullorja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e ka përcaktuar, kur nuk ka shkelje që pasjellin nisjen e një procedimi disiplinor, i tërhiqet vëmendja. Unë edhe në atë moment që kam qenë inspektor i KLD-së, kam patur kontestime në këtë, por kjo gjithmonë merret në kuadër të vlerësimit të gjyqtarit dhe këtë rast nuk mund ta quajmë si rast të përsëritur dhe për këtë shkak, nuk mundet që Ministri të vinte me një masë ekstreme, për ta konsideruar si shkelje në mënyrë të përsëritur” - (pasqyruar në faqen 26 të procesverballit).

Në vijim të paragrafit 10/2 të vendimit nr. 89, përcaktohet se: “Shkak për këtë është dhënia e vendimit nr. 2359 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me palët përkatëse, vendim i cili është ndryshuar nga gjykata e apelit, ku ka rezultuar moszbatim formal i ligjit, duke shkelur dispozitat urdhëruese procedurale, duke mos garantuar një proces të rregullt ligjor.”

Këtu zoti Muharremaj bën një parantezë dhe thekson: “Këto janë shkaqet e cenimit të vendimit nga ana e gjykatës së apelit”. Dhe pse është sqaruar më sipër se tërheqja e vëmendjes dhënë mbi këtë shkelje, e cituar nga ana e zotit Muharremaj, qartazi nuk është masë disiplinore dhe nuk mund të konsiderohet rast i përsëritur, pa lënë mënjanë kohën e gjatë nga ky procedim, sqarojmë edhe një herë se shkaqet e ndryshimit të këtij vendimi nga gjykata e apelit janë tërësisht të tjera dhe jo si relatohen në atë vendimmarrje apo si u cituan në keqpërdorim të plotë të situatës procedurale dhe në relatin objektive procedural të çështjes. Nëse ky qëndrim nuk do të ishte i dukshëm tendencioz, nëse vërtet synohet kryerja e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, lehtësisht konstatohet se jo moszbatimi formal i ligjit apo shkelja e dispozitave urdhëruese procedurale janë shkaqet e cenimit të atij vendimi nga ana e gjykatës së apelit.

Pas një hetimi të plotë dhe të provuar si tendencioz nga ana e Inspektoratit të ish-KLD-së, ka konstatuar si shkelje vetëm dy fakte: Zgjatjen e gjykimit për 6 muaj dhe 11 ditë dhe dorëzimin me vonesë të vendimit të arsyetuar.

Në vijim, zoti Muharremaj citon paragrafë të tjerë, duke pretenduar se ka shkelje disiplinore që përbëjnë akte që diskreditojnë figurën e gjyqtarit.

Do ndalem shkurt. Në qoftë se do të kishim akte që diskreditojnë figurën e gjyqtarit, nuk do të ishte mjaftuar Këshilli me një tërheqje vëmendjeje, por do të kishte vijuar me procedimin disiplinor. Nuk ka patur të tilla, ndaj është gjetur një mënyrë për ta cenuar gjyqtari në atë periudhë.

Sa i takon mënyrës së arsyetimit të vendimit nr. 89, ai vendim është... pjesa arsyetuese referon tek qëndrimi personal i Zëvendëskryetarit/Nënkryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili paraprakisht ka kryer funksionin e Kryetarit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. E kemi sqaruar në mënyrë të hollësishme dhe nuk do ndalemi më atje, por nuk pasqyron në asnjë moment diskutimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Siç dhe relatuar më sipër, vendimi nr. 89, datë 07.07.2014 është një vendim i një organi kolegjal dhe ky vendim ka vlerë bashkë me procesverbalin e mbledhjes, në të kundërt ai konsiderohet i pavlefshëm. Mendojmë se shkak i mospublikimit të procesverbalit të mbledhjes në faqen e KLD-së, ka qenë pikërisht kjo mospërputhje e arsytimit të vendimit me diskutimin e mbajtur në mbledhje.

Duke qenë se arsyetimi i këtij vendimi nuk është në unison me atë çka është diskutuar në procesverbal, mendojmë se edhe për këtë shkak ky procesverbal nuk është bërë asnjëherë publik (duke patur rezervat tona edhe për mënyrën e zbardhjes së këtij procesverbali).

Është e gabuar që të tentosh t'i japësh prioritet paragrafëve të këtij vendimi, të cilat nuk shprehin qëndrimin e një organi kolegjal, sa kohë që ligji “Për funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, në nenin 18 ka përcaktuar se: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e tij”. Ndërsa neni 98, pika 5 e Kodit të Procedurave Administrative, “Forma e aktit administrativ” përcakton se: “Në procesverbal pasqyrohen data, vendi, anëtarët që morën pjesë, diskutimet e pjesëmarrësve. Çdo anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka të drejtë të verifikojë përmbajtjen e procesverbalit dhe të paraqesë objeksionet e veta, të cilat i bëhen të ditura Këshillit të Lartë të Drejtësisë në mbledhjen pasardhëse. Çdo anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti se ai ka votuar kundër vendimit të marrë, si dhe arsyetimet e vendimit kundër”.

Pra çdo anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka patur detyrimin funksional por edhe moral të verifikonte mënyrën e arsytimit të vendimit nga ana e Nënkryetarit të këtij Këshilli dhe të kërkonte që ky arsyetim të vinte në unison me atë çka është vendosur në mbledhje. Gjyqtari nuk mund të kërkonte arsyetimin e këtij vendimi, i cili rezulton të jetë i paarsyetuar, sa kohë që jo vetëm diskutimi bëhej me dyer të mbyllura pa prezencën e tij, por gjyqtarit, ligji i kohës i njëjtte të drejtën e ankimit vetëm në rastin e marrjes së masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, referuar nenit 34/1 të ligjit.

Sa më sipër, rezulton e mbështetur proceduralisht, kërkojmë prej këtij Këshilli të administrojë në cilësinë e provës, dosja e plotë e procedimit disiplinor, përfunduar me vendimin nr. 89, datë 07.07.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në kuadër të plotësisë

së kushteve ligjore të një procesi të rregullt ligjor në këtë procedim disiplinor, duke parashtruar në mënyrë të hollësishme edhe situatat ligjore ku referon ... (*nuk dëgjohet fjala mbyllëse e zonjës {...}*).

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë, po e kaloj fjalën tek zoti Inspektor i Përgjithshëm, lidhur me kërkesën që ka bërë subjekti në procedim.

**Artur Metani:** Inspektor i Lartë, jo i Përgjithshëm.

Në fakt, edhe në seancën e kaluar, por edhe në parashtrime, unë nuk e shoh me vend dhe nuk ka lidhje me parashtrësit dhe gjithë procedimin që Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka sjellë para Këshillit. Kështu që unë nuk e shoh ose e shoh me vend edhe kërkesën e paraqitur nga magjistrati për mosadministrimin e kësaj prove ose këtij dokumenti.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

*{...}*: Kam diçka, e nderuar Kryetare dhe anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Si subjekt i këtij procedimi disiplinor, jam plotësisht i paqartë lidhur me arsyen e administrimit të dosjes personale nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Administrimi i kësaj dosjeje personale ka ardhur si rrjedhojë e ndërhyrjes së anëtarit të këtij Këshilli, z. Muharremaj dhe nuk jemi të njohur domethënë dhe nuk jam i qartë domethënë përse u administrua. Kjo edhe në një drejtim tjetër - gjithçka po e relatoj që pse e kërkoj administrimin e praktikës së plotë të procedimit disiplinor të vitit 2014. Referuar nenit 17, pikës /c/ të Rregullores të Këshillit të Lartë Gjyqësor për procedimet disiplinore, rezulton se pjesë përbërëse e materialeve të dosjes që i vihen në dispozicion mbledhjes plenare të Këshillit është edhe dosja personale e magjistratit. Në këtë rast kemi një diskordancë ndërmjet asaj çfarë përfaqëson/relaton Rregullorja, ku dosja personale e magjistratit duhet të ishte prezent në materialet e çështjes dhe vendimmarrjes së këtij Këshilli. Është në të drejtën tuaj si dhe në të drejtën time të më sqaroni domethënë për cilën arsye dhe cili ka qenë motivi i administrimit të kësaj dosjeje. Në qoftë se motivi i

administrimit të kësaj dosjeje ka qenë fikësimi nga pikëpamja formale si provë e vendimit nr.89/2014, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, atëherë është absolutisht e domosdoshme dhe kërkesa ime për administrimin e të gjithë materialeve të plota të procedimit disiplinor të vitit 2014 ndaj meje si gjyqtar, duhet të jetë pjesë përbërëse e materialeve të dosjes në parim të respektimit të parimit të kontradiktoritetit por dhe të krimit të mundësive reale të mbrojtjes dhe ballafaqimit të fakteve dhe provave në raport me fjalën që mbajti një anëtar i nderuar i këtij Këshilli. Në të kundërtën, nuk e kam fare të qartë këtë lloj procedimi domethënë se çfarë po ndodh dhe pse ndodhi. Kjo është arsyeja dhe motivi kryesor që kërkoj. Sepse në rast se nënteksti i administrimit të atij vendimi, në qoftë se ka qenë ky për administrimin e dosjes personale, është për t'u cilësuar pasi është real apo jo, etj., në këtë drejtim, për t'u cilësuar se kemi të bëjmë me shkelje të përsëritura nga ana ime si magjistrat, atëherë është shumë e nevojshme që të administrohet dosja e atij procedimi, për të më dhënë mundësinë të prapësoj këtë lloj qëndrimi apo këtë lloj pretendimi. Kjo ka qenë edhe arsyeja që është kërkuar administrimi si provë e dosjes së plotë të këtij procedimi. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, faleminderit!

Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Sikurse edhe ju cituat, pjesë e materialeve të procedimit duhet të jetë në çdo rast edhe dosja e gjyqtarit. Kjo ka qenë arsyeja që Këshilli, në momentin që u njoh që nuk ishte pjesë e materialeve të procedimit disiplinor dosja e gjyqtarit, vendosi kryesisht që ta bëjë pjesë të materialeve të procedimit. Kaq ka vendosur Këshilli. Nuk ka ndonjë arsye tjetër që ju të prononcoheni.

*(Zonja {...} ndërhyr pa mikrofon.)*

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Tani mund të rrini të qetë, dhe Këshilli të diskutojë kërkesën tuaj të re.

**Naureda Llagami:** Atëherë, pa dashur të përsëris çfarë tha zoti Toska, atëherë Këshilli tërhiqet për vendimmarrje lidhur me kërkesën tuaj të re, lidhur me

pranueshmërinë apo jo të asaj që ju kërkoni, kështu që ju ftoj të vazhdoni jashtë, për të lejuar Këshillin që të marri vendim mbi çështjen.

*(Dalin nga salla e mbledhjes magistrati, z. {...} bashkë me avokaten znj. Marçela {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Perian Teta. Procesverbali vijon në mënyrë të përmbledhur deri në momentin kur palët rifuten në sallë.)*

I pari që merr fjalën është relatori i çështjes z. **Hallunaj** i cili jep mendimin e tij lidhur me kërkesën e re të magistratit {...}, duke u shprehur se nuk e shikon me vend që procedimi i vitit 2014 të përfshihet në dosjen personale të magistratit, pra zoti Hallunaj nuk e shikon të nevojshme marrjen e dosjes së procedimit disiplinor duke propozuar rrezimin e kërkesës së magistratit {...}.

Më tej fjalën e merr **zonja Kadi** e cila është e mendimit se dosja e magistratit duhet të merret si provë, kjo për faktin se magistrati e ka një argument pse e kërkon, ndaj zonja Kadi është pro administrimit të dosjes.

Edhe **zonja Ukperaj** merr fjalën për të shprehur mendimin e saj lidhur me kërkesën e magistratit dhe shprehet se nga ajo çka kishte kuptuar nga fjala e magistratit {...}, ishte se ai vinte në dyshim vërtetësinë e arsytimit dhe të dhënave të vendimit të tij të mëparshëm (pra të vitit 2014) referuar të dhënave të procesverbalit. Sipas zonjës Ukperaj, vendimi i ish-Këshillit që është pjesë e dosjes personale është një akt me fuqi të plotë vepruese si dhe nuk është në autoritetin e Këshillit që të vlerësojë faktet e pretenduara nga z. {...}. Edhe zonja Ukperaj bashkohet me mendimin e zotit Hallunaj, që aktet shtesë të kërkuara nga z. {...}, nuk mund të merren si provë për efekte të këtij procedimi, pasi e para, nuk kanë lidhje me çështjen në fjalë dhe e dyta, nuk mund të vihet në diskutim vendimmarrja dhe arsytimi i ish-Këshillit.

**Zoti Toska** gjithashtu merr fjalën për të shprehur arsyet e tij se pse nuk duhet pranuar kërkesa e bërë nga magistrati z. {...}, e para për faktin se praktika e procedimit disiplinor nuk është pjesë e dosjes personale të magistratit dhe e dyta është sepse ky

Këshill nuk mund të shqyrtojë procedimet disiplinore të mëparshme të një organi tjetër. Ato akte janë materiale arkivore.

Edhe **zonja Luli** nuk është dakord me pranimin e kërkesës së z. {...} për administrimin e procedimit disiplinor të vitit 2014, për shkak se tashmë ai vendim ka marrë formë të prerë dhe gjendet në dosjen personale të gjyqtarit dhe ndërkohë, s'ka asnjë vlerë administrimi i akteve të tjera pasi nuk bëjnë ndryshimin e vendimmarrjes, e cila është e formës së prerë. Ndërsa, sa i përket dosjes personale, ajo duhet të pjesë e administruar në të gjitha rastet e procedimeve disiplinore.

Në fund merr fjalën për të shprehur edhe ai mendimin e tij, z. **Toro**, i cili është për pranimin e kërkesës së z. {...} bazuar në parimin e barazisë së armëve dhe meqenëse gjyqtari mendon që marrja e këtyre akteve do t'i shërbejë si provë.

Duke qenë se anëtarët nuk kanë më diskutime, kalohet në procesin e votimit lidhur me pranimin ose jo të kërkesës së bërë nga subjekti nën procedim disiplinor, lidhur me administrimin në cilësinë e provës shkresore të dosjes së plotë të procedimit disiplinor, përfunduar me vendimin nr. 89, datë 07.07.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë:

**Maksim Qoku:** Kundër pranimin të kërkesës së subjektit.

**Brunilda Kadi:** Pro kërkesës së subjektit.

**Dritan Hallunaj:** Kundër pranimin të kërkesës së subjektit.

**Ilir Toska:** Kundër pranimin të kërkesës së subjektit.

**Alban Toro:** Pro kërkesës së subjektit.

**Fatmira Luli:** Kundër pranimin të kërkesës së subjektit.

**Marçela Shehu:** Kundër pranimin të kërkesës së subjektit.

**Erjon Muharremaj:** Kundër pranimin të kërkesës së subjektit.

**Brikena Ukperaj:** Kundër pranimin të kërkesës së subjektit.

**Medi Bici:** Pro kërkesës së subjektit.

**Naureda Llagami:** Kundër pranimin të kërkesës së subjektit.



Atëherë, Këshilli vendosi: Mospranimin e kërkesës së magistratit z. {...}, për administrimin në cilësinë e provës shkresore të dosjes së plotë të procedimit disiplinor, përfunduar me vendimin nr. 89, datë 07.07.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me arsyetimin se materialet e procedimit të mëparshëm disiplinor nuk janë pjesë e dosjes personale, dhe të dhënat që ato sjellin kapërcejnë objektin e këtij shqyrtimi.

*(Hyjnë në sallën e mbledhjes magistrati, z. {...} bashkë me avokaten znj. Marçela {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Periand Teta.)*

*(Duke qenë se mikrofonin e Kryetares së Këshillit gjatë komunikimit palëve mbi atë çka anëtarët e Këshillit vendosën pak më parë, ripërsëritet si më poshtë fjala e saj me mikrofon të hapur.)*

**Naureda Llagami:** Për efekt të regjistrimit dhe të komunikimit, më lejoni që ta përsëris edhe një herë.

Këshilli vendosi: Mospranimin e kërkesës së magistratit {...} për administrim në cilësinë e provës shkresore të dosjes së plotë të procedimit disiplinor përfunduar me vendim nr. 89, datë 07.07.2014, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me arsyetimin se materialet e procedimit të mëparshëm disiplinor nuk janë pjesë e dosjes personale, dhe të dhënat që ato sjellin kapërcejnë objektin e këtij shqyrtimi.

Ky është vendimi i Këshillit.

Përpara se të shkojmë në fazën tjetër të shqyrtimit, i kërkoj palëve nëse kanë kërkesa të tjera paraprake.

**Artur Metani:** ILD-ja nuk ka kërkesa.

**(Avokatja):** Kërkesa jonë për administrimin e dosjes së procedimit disiplinor nuk u pranua prej jush, me argumentimin se nuk janë pjesë të dosjes personale. A nuk duhet të ishin pjesë e dosjes personale? Nuk bëjnë pjesë në dosjen personale të gjyqtarit gjithçka që është e lidhur me karrierën e tij?

Nëse jo, -domethënë mund të jetë një lapsus ose një gabim dhe nuk është administruar dhe mbi këtë shkak të mos administrohen sot?

**Ilir Toska:** Ju lutem!

Dosja personale rregullohet ligjërisht.

Nëse ju keni ndonjë koment për dosjen personale, mund a bëni referuar ndonjë dispozite ligjore.

(Zonja {...} ndërhyr.)

Të lutem, më dëgjo!

Ju vini dhe na bëni ne pyetje: -Pse nuk është kjo pjesë e dosjes?

Ligjërisht nuk është.

Nëse mendoni ndryshe, mund të më thoni që ligji është ndryshe.

Kaq është.

{...}: Për të mos e zgatur, por jam i detyruar të them.

Minimalisht, në dosjen personale ndodhet i administruar vendimi nr. 89/2014 të ish-KLD-së. Ne sapo parashtruar, që të jetë i vlefshëm ai vendim, duhet patjetër të shoqërohet me procesverbalin e mbledhjes së Këshillit. Ndryshe është i pavlefshëm. Pra dosja personale mban të administruar një vendimmarrje që në bazë të Kodit të Procedurave Administrative është e pavlefshme.

Në qoftë se ky është qëndrimi i Këshilli, nuk ka asnjë lloj problematike të mëtejshme.

**Ilir Toska:** Ju lutem, mos na vini në pozitë, që të bëjmë komente.

Kërkesa, nëse keni, mund t'i bëni.

(Zonja {...} ndërhyr.)

**Ilir Toska:** Të lutem, mos flisni kur unë flas.

Përpiqu të na kuptoni ne, procesin dhe atë që keni ju të drejtë të bëni.

Ne kemi vendosur që të administrojmë dosjet personale, jo vetëm në këtë rast, por në çdo rast do të duhet që të administrojmë dosjen personale. Është rregull bazë. Kështu kemi vepruar edhe në këtë rast. Pjesë e dosjes personale nuk janë dosjet e procedimeve

disiplinore, por vetëm vendimet. Ju kërkua të administrojmë dosjen e procedimit. Vendosëm ta refuzojmë këtë kërkesë.

Kryetarja ju pyeti: -A keni kërkesa të tjera?

Mos vazhdoni të na kërkoni shpjegime se pse ne mendojmë kështu, apo ju mendoni ndryshe.

Ju thashë, dosja personale rregullohet ligjërisht çfarë dokumentacioni përmban brenda dhe ne kemi marrë të gjithë dokumentat që ligjërisht janë në dosje. Kaq është.

*(Avokatja):* Mund të bëj vetëm një parantezë të vogël?

*Ilir Toska:* Jo, nuk mund të bëni asnjë parantezë. Nuk mund të bëni asgjë në këtë moment. Vendimi i Këshillit ju deklarua. Nëse keni kërkesa të tjera, mund të na i thoni.

*(Avokatja):* Unë jam shumë dakord që pjesë e dosjes personale është vetëm vendimi 89 dhe do isha shumë dakord me faktin që kjo dosje të administrohej dhe të ishte administruar mbase edhe më përpara, por mos të harrojmë që në seancën e datës 21.10, ai vendim u mor dhe u analizua i copëtuar, duke i dhënë tendencën dhe theksin atje ku i interesonte... dhe për këtë shkak kërkojmë që të administrohet procesverbali.

*Naureda Llagami:* Edhe një herë.

Atëherë, Këshilli mori vendim për këtë.

Ju lutem, keni kërkesa të tjera sepse ne u shprehëm me vendim për këtë çështje.

*{...}*: Po! - kam edhe një kërkesë të fundit.

Ato që kam parashtruar si magjistrat gjatë fjalës time, lidhur me handicapin ndërmjet mbledhjes plenare dhe seancës dëgjimore dhe kompetencave përkatëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor për këto dy faza procedurale; duke u mbështetur në aktet që komunikohen dhe qëndrimin që mban i nderuari zoti Inspektor i Lartë i Drejtësisë, jam fare i paqartë në këto momente si magjistrat, nëse ky procedim, kjo mbledhje apo kjo seancë dëgjimore, po zhvillohet për të pranuar kërkesën e Inspektorit vetëm për fillimin e

hetimit disiplinor nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo jemi në seancë dëgjimore që Këshilli i Lartë Gjyqësor të shprehet lidhur me pranimin ose jo të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin e masës disiplinore?

Nuk e kuptoj se në çfarë faze jam dhe kush është pozita ime procedurale si magjistrat në këtë moment? Jam në procedim disiplinor, apo jemi në shqyrtimin e kërkesës për vendimmarrjen e këtij Këshilli për fillimin ose jo të hetimit disiplinor?

**Ilir Toska:** Sipas jush, në çfarë pozite jeni?

Sipas jush, në çfarë pozite jeni? – Sepse keni ardhur këtu, keni bërë parashtresa dhe tani vini na bëni pyetje: -Çfarë pozite kam unë?

Nëse nuk e dini çfarë pozite keni, nuk e di pse keni vazhduar deri tani?

**{...}**: I nderuar anëtar dhe të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Po e them këtë, pasi jam njohur me praktikën që ka ndjekur Këshilli i Lartë i Prokurorisë në një rast analog, e cila është komplet e ndryshme nga kjo që po procedojmë në këtë moment. Ndërkohë që, si Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe ju si Këshilli i Lartë Gjyqësor, veprimtarinë e mbështesni vetëm në dy ligje: në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithsesi, në kuptim dhe në mirëkuptim të plotë, ju lutem, jemi në seancë për pranimin apo jo të fillimit të hetimit disiplinor të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo produkti i kësaj seance do jetë vendimmarrja për masën disiplinore?! Nuk e kam të qartë fare këtë gjë.

**Dritan Hallunaj:** Atëherë, mundem?

**Naureda Llagami:** Po, zoti Hallunaj!

**Dritan Hallunaj:** Nëse ju nuk e keni të qartë, është problemi vetëm i juaji mendoj unë.

Kryetarja dhe drejtuesja e seancës tha me të drejtë: - A keni prova të tjera në këtë shqyrtim gjyqësor, se do mbyllet shqyrtimi dhe do kalohet në konkluzionet përfundimtare, për të mos thënë, që në seancën e shkuar dëgjimore, ju është thënë që

përgatitni edhe konkluzionet përfundimtare dhe unë, me lejen edhe të Kryetares, po ju them: - A keni prova të tjera në këtë seancë dëgjimore?

{...}: Edhe po të kem, është e sigurt që nuk do pranohen. Por, nuk kam prova të tjera.

**Naureda Llagami:** Atëherë, nga palët nuk kemi kërkesa të tjera për prova.

Kështu që, në zbatim të rregullores, në kushtet që ne nuk kemi kërkesa të reja për prova, deklaroj mbylljen e shqyrtimit dhe i kërkoj palëve të kalojmë në fazën e fundit, që ka të bëjë me pretendimet përfundimtare.

Jeni gati për të kaluar në këtë fazë për pretendimet përfundimtare?

**Artur Metani:** Po!

**Naureda Llagami:** Nga ana e Inspektorit të Lartë, po!

Nga ana e subjektit?

{...}: Do shprehem pasi të dëgjoj Inspektorin.

**Naureda Llagami:** Atëherë, vazhdojmë me Inspektorin e Lartë.

**Artur Metani:** Unë i kam përgatitur me shkrim konkluzionet përfundimtare dhe do i dorëzoj/depozitoj.

Për të mos e bërë të lodhshme seancën, do bëj vetëm një përmbledhje të shkurtër për ju.

E nderuar zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Në përfundim të këtij procedimi disiplinor, si për sa i përket fakteve të provuara, ashtu edhe pretendimeve të paraqitura nga ana e magjistratit, subjekt procedimi, në cilësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dëshiroj të theksoj edhe një herë, se magjistrati ushtron funksionin në mënyrë të pavarur, por ai nuk mund të veprojë në mënyrë arbitrare

dhe të gjykojë rastet duke u bazuar në preferencat personale, interesin vetjak apo keqbesimin, por vetëm duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe duke interpretuar atë në varësi të rrethanave konkrete të një çështjeje gjyqësore të caktuar.

Pavarësia që i njihet magjistratit nuk është një qëllim në vetvete, një privilegj personal, por është një mjet për të mbrojtur publikun që kërkon dhe pret drejtësi. Pavarësia e magjistratit shkon përkrah dhe balancohet nëpërmjet një sistemi llogaridhënieje, përgjegjshmërie dhe ndëshkueshmërie.

Në rastin konkret, duke mbajtur në konsideratë natyrën e shkeljes disiplinore, rrethanat e shkeljes së kryer, të cilat kanë të bëjnë me mosrespektimin e rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal, kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit me dashje direkte, pasojat e shkeljes disiplinore lidhur me dënimin e një të dënuari të rrezikshëm, i cili përbën rrezik për komunitetin ... në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit material dhe procedural penal, cenimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, fakti që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën shkelje të rëndë disiplinore, arrihet në konkluzionin se veprimet dhe mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit {...} janë aq serioze, sa kanë cenuar vlerat themelore të sistemit, besimin që magjistrati duhet të përcjellë tek publiku në përmbushjen e misionit dhe rolit të tij në dhënien e drejtësisë, kanë diskredituar rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit dhe kanë ulur dinjitetin e organit që përfaqëson, duke e bërë atë të padenjë për vazhdimin e ushtrimit të funksionit të magjistratit.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, të administrojë provat e paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh”, nenit 111, pika 1 dhe nenit 146, pika 2, shkronja “a” e ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendosë: Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me procedimin disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Metani!

Atëherë, fjalën po ia jap subjektit, zotit {...}!

**{...}:** Faleminderit, Kryetare!

Duke qenë se edhe parashtrimet nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u paraqitën në mënyrë të shkurtuar, por jo thelbësisht për këtë arsye; duke patur parasysh zhvillimet procedurale dhe duke qenë se vetëm në këtë moment jam i qartë lidhur me karakterin e seancës dëgjimore, do kërkoja një kohë fare minimale, për paraqitjen e diskutimit përfundimtar në këtë çështje.

**Naureda Llagami:** Atëherë, do ishte mirë së pari që ju të na i parashtroni me shkrim përpara se ne të lëmë seancën.

**{...}:** Absolutisht, po!

**Naureda Llagami:** Kështu që, unë do propozoja që të tërhiqet Këshilli për të marrë edhe mendimin e anëtarëve të tjerë, lidhur me caktimin e seancës dhe kohën kur ju duhet t'i parashtroni me shkrim përpara Këshillit.

**{...}:** Faleminderit!

*(Dalin sërish nga salla e mbledhjes magjistrati, z. {...} bashkë me avokaten znj. Marçela {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Periand Teta. Vijohet diskutimi vetëm në prezencë të anëtarëve. Pas diskutimeve nga anëtarët, rihyjnë në sallën e mbledhjes palët.)*

**Naureda Llagami:** Atëherë, Këshilli vendosi që ta ndërpresë seancën e sotshme për t'i dhënë mundësi palës për të përgatitur konkluzionet përfundimtare, duke e shtyrë

seancën e radhës më datë 10 dhjetor, ora 12:00 dhe deri më datë 4 dhjetor, pala ka detyrimin të parashtrorjës përpara Këshillit me shkrim parashtrësën e tij.

Me kaq e mbyllim seancën e sotshme.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**